



Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 530, datë 11.11.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË BANESAVE INDIVIDUALE
DHE TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEZA (PALLAT),
NË BASHKITË DURRËS, LEZHË DHE KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 318 330 000 (treqind e tetëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Durrës, Lezhë e Kamzë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, dhe t’u kalojë bashkive Durrës, Lezhë dhe Kamzë, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë

e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, përkatësisht, si më poshtë vijon:

- a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 63 250 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh;
 - b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi prej 78 750 000 (shtatëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh;
 - c) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi prej 176 330 000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e tridhjetë mijë) lekësh.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës, Lezhë e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN
ARBËN AHMETAJ**

NR.PROT. 5728/1
DATË 12.11. 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE
BASHKIVE DURRËS, LEZHË DHE KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

Në mungesë dhe me porosi

Elira KOKONA

